



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-24805/2018

Datë. 05.01.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 05.01.2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla , znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa , znj. Dijana Qarkagjija, z. Basri Komoni, znj. Hana Zeka , znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova , znj. Mimoza Shala , znj. Lirika Komoni , z. Krishnik Alijaj, z. Bekim Jupa , znj. Dafina Syla, znj. Miranada Lushaj , z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, .

Mungojnë : z. Halit Isufi, z. Edmond Dushi me arsye.

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetar i Komunës z. Ardian Gjini, të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës , Drejtor të drejtorive Komunale Të nderuar përfaqësues të Mediave, të OSBE, të nderuar të pranishëm. Fillimisht ju uroj Vitin e ri 2018 të gjithë juve dhe qytetarëve të Komunës së Gjakovës .

Sot do ta kemi mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, ju njoftoj se Kuvendi për këtë mbledhje i ka 34 anëtarë, për shkak se një anëtar nga AAK është në procedurë të certifikimit, të pranishëm në këtë mbledhje janë: 32, anëtarë, z. Edmond Dushi, ka njoftuar se mungon në këtë mbledhje sepse gjendet në një udhëtim jashtë vendit , meqenëse ekziston kuorumi po fillojmë me mbledhjen .

Para se të kalojmë tek pikat e rendit të ditës i ftoj që të bëjnë betimin anëtarët e ri të Kuvendit që janë certifikuar pas procedurave të rregullta që janë zhvilluar në KQZ, andaj i ftoj që të bëjnë betimin, znj. Albina Sadrija nga Subjekti AAK , znj. Miranda Lushaj nga Subjekti Politik PDK, z. Jeton Vorfi nga Subjekti Politik Alternativa, ju ftoj që të dilni në foltore dhe gjithsecili njëkohësisht të bëni betimin duke e lexuar tekstin e betimit .

Konstatohet se znj. Albina Sadrija nga Subjekti AAK , znj. Miranda Lushaj nga Subjekti Politik PDK, z. Jeton Vorfi nga Subjekti Politik Alternativ, e bënë betimin sipas Ligjit për vetëqeverisje Lokale .

Kryesuesi: Urime për anëtarët e ri të Kuvendit ju dëshirojmë suksese në angazhimet e juaja .

Kryesuesi : Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën e mbledhjes. Andaj a ka dikush ndonjë propozim sa i përket Rendit të Ditës .

E qes në Votim Rendin e Ditës për mbledhjen e sotme sipas ftesë së bërë. Kush është: Për , Kundër, Abstenim

Nga anëtarët e Kuvendit unanimitisht u miratua Ky :

REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit e mbajtur me dt. 18.12.2017 .
2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa .
3. Themelimi i Komitetit për Komunitete .
4. Të ndryshme.

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit e mbajtur me dt. 18.12.2017 .

Kryesuesi: Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit e mbajtur me dt. 18.12.2017, a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverbal .

E qes në Votimi miratimin e Procesverbaleve , **Kush është: Për, kundër, Abstenim**

Nga Anëtarët e Kuvendit të Komunës Unanimitisht u miratua procesverbal nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit e mbajtur me dt. 18.12.2017 .

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, i cili është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, në Statutit të Komunës së Gjakovës, dhe në Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.03/2014, i cili duhet të ketë gjithsejtë 9 anëtarë përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit i cili është Kryesues edhe i këtij komitetit andaj kërkohet që të paraqitni propozimet e juaja për anëtar të këtij komitetit, ku të gjitha subjektet politike anëtare të Kuvendit do të jenë të përfshira në këtë komitet me nga një anëtar në veçanti AAK do ti ketë 2 anëtar andaj kërkoj sipas radhës që të bënë propozimet e juaja për anëtar të Komitetit për Politik dhe Financa .

A pajtoheni që të procedojmë sipas këtij propozimi Kush është: Për Kundër , Abstenim. Nga anëtarët e Kuvendit u votua kështu : 27 pro, 4 Kundër 1 abstenim .

Fillojmë me radhë nga AAK-ja që të paraqesin propozimet e tyre për anëtar të KPF-së

z. Muharrem Musa : Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i ka dy propozime që janë znj. Florentina Gjergjaj dhe z. Haxh Sejtiu .

z. Jeton Forfi : Alternativa propozon znj. Diana Qarkagjija .

znj. Dafina Syla : Partia Demokratike e Kosovës propozon z. Bekim Jupa

znj. Mimoza Shala: Lëvizja Vetëvendosje propozon z. Agon Batusha

Kryesuesi: kërkoj nga Subjektet politike që të kemi parasysh përqindjen e gjinisë femërore sepse deri më tani i kemi vetëm dy propozime nga kjo gjini andaj kërkoj mirëkuptimin tuaj që të përmbushet ky kusht. Kërkoj nga Subjekti Politik LDK që të paraqet propozimin e radhës.

z. Sadik Hoti: Lidhja Demokratike e Kosovës propozon z. Bekim Ermeni

Kryesuesi: Në emër të PSHDK-së me automatizëm shkon Kryesuesi i Kuvendit, ftojme Nismën që të praqes propozimin .

Znj. Valentina Alija : Nisma për Kosovën propozon z. Fazli Hoxha

Kryesuesi: Pasi përfaqësuesi i AKR-së nuk është prezent në mbledhje dhe ky subjekt e ka vetëm një anëtar e propozoj z. Edmond Dushi

E Hapi diskutimin për këtë pik të rendit të ditës.

Kryesuesi: Pasi kemi vetëm dy propozime nga gjinia femërore ne po vazhdojmë në këtë mënyrë dhe shohim se si të veprojnë Ministria. E qes në votim themelimin e Komitetit për Politik dhe Financa sipas përbërjes së propozuar : **Kush është për Kundër Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në mënyrë unanime u votua pro këtij propozimi dhe pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Gjakovës prej 9 (Nëntë) anëtarëve , me këtë përbërje:

1. z. Haxhi Sejdiu përfaqësues nga AAK
2. znj. Florentina Gjergjaj, përfaqësuese nga AAK
3. znj. Diana Qarkagjija , përfaqësuese nga Alternativa
4. z. Bekim Jupa , përfaqësues nga PDK
5. z. Agon Batusha, përfaqësues nga VV.
6. z. Bekim Ermeni, përfaqësues nga LDK
7. z. Anton Shala , Kryesues i Kuvendit
8. z. Fazli Hoxha, përfaqësues nga NISMA
9. z. Edmond Dushi, përfaqësues nga AKR

2. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. **Anton Shala.**

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës

3.Pika e tretë e rendit të ditës: Themelimi i Komitetit për Komunitete

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit e kemi Themelimi i Komitetit për Komunitete, i cili duhet ti ketë gjithsejtë 9 anëtar në përbërjen e të cilit duhet të ketë nga një përfaqësues i të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Gjakovës, dhe anëtar të Kuvendit të komunës së Gjakovës, ne në bashkëpunim me Zyrën

Komunale për Komunitete dhe Kthim, i kemi marrë propozimet për përfaqësuesit e Komuniteteve andaj janë gjithsejtë 5 kështu që mbeten edhe 4 anëtar të Kuvendit që i ftoj 4 subjektet më të mëdha politike që të paraqesin nga një propozim për anëtar të Komitetit për Komunitete, unë do ti lexoi emrat që i kemi marrë në bashkëpunim me ZKKK, të përfaqësuesve të Komuniteteve në Komunën e Gjakovës .

z. Fadil Podrimjaznj. Elvana Qorri z. Senad Gushani dhe z. Zenel Hajdari dhe znj. Ifeta Jakupi nga komunitetet pakicë dhe tani kërkoj nga 4 subjektet e mëdha në Kuvend që ti paraqesin propozimet e tyre .

z. Muharrem Musa : Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon z. Jusuf osmani.

z. Jeton Forfi : Alternativa propozon znj. Edi Gaxha Puka

z. Bekim Jupa : Partia Demokratike e Kosovës propozon znj. Dafina Syla .

z. Shpend Kumnova: Lëvizja Vetëvendosje propozon znj. Mimoza Shala.

Kryesuesi: E qes në votim themelimin e Komitetit për Komunitetea sipas përbërjes së propozuar : **Kush është për Kundër Abstenim .**

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në mënyrë u votua Kështu : 28 pro , 1 Kundër dhe 3 abstenim, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Gjakovës me këtë përbërje:

1. znj. Elvana Qorri, përfaqësuese e Komunitetit Egjiptian
2. z.Fadil Podrimja, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian
3. z. Senat Gushani, përfaqësues i Komunitetit Rom
4. znj. Zenel Hajdari, përfaqësues i Komunitetit Ashkali
5. znj. Ifeta Jakupi , përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak
6. z. Jusuf Osmani, përfaqësues i AAK-së
7. znj.Edi Gaxha Puka , përfaqësuese e Alternativës
8. znj. Dafina Syla , përfaqësuese e PDK-së
9. znj. Mimoza Shala , përfaqësuese e VV-së

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.

Kryesuesi: Unë do të konsultohem edhe një herë me ligjin sa i përket pikës së ndryshme sepse unë nuk pajtona që në të ndryshme të diskutohet pa asnjë kriter.

4.Pika e katërt e rendit të ditës: Të Ndryshme .

Kryesuesi: Kërkoj nga Subjektet Politike të përfaqësuar këtu në Kuvend që të caktojnë shefat e grupeve të tyre në Kuvend për shkak të komunikimit në emër të Grupit andaj kërkoj nga të gjitha subjektet politike të na njoftojnë se kush është shef i grupit të tyre.

z. Haxhi Sejdiija: Grupi i anëtareve të AAK-së e ka caktuar si shef të grupit z. Muharrem Musa

z. Jeton Vorfi: Grupi i anëtareve të Alternativës e ka caktuar si shef të grupit znj. Diana Qarkaxhija

znj. Dafina Syla: Grupi i anëtareve të PDK-së e ka caktuar si shef të grupit z. Bekim Jupa

znj. Mimoza Shala : Grupi i anëtareve të VV-së e ka caktuar si shef të grupit z. Agon Batusha

znj. Besarta Leka: Grupi i anëtareve të LDK-së e ka caktuar si shef të grupit z. Bekim Ermeni

z. Arjeta Gjoklaj: Grupi i anëtareve të PSHDK-së e ka caktuar si shef të grupit z. Zef Komani

znj. Valentina Alijaj: Grupi i anëtareve të Nisma e ka caktuar si shef të grupit z. Fazli Hoxha.

Kryesuesi: AKR-ja e ka vetëm një anëtar dhe këta emra nuk kanë nevojë që të votohen .

Kryesuesi: Dua të ju përkujtoj edhe një herë se Formulari i Deklarimit të Pasurisë duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve pas marrjes së detyrës andaj jemi të obliguar që ti përmbaheni , kush dëshiron që ti dorëzojmë nga zyra e Kryesuesit kërkoj që ti dorëzoni sot sepse të martën do ti dorëzojmë në Prishtinë, ato që i keni dorëzuar në sekretarin e Kuvendit, mirëpo kjo është zgjedhja e juaj sepse mundeni ti dorëzoni edhe përmes Postës, andaj kërkoj që të përmbushni këtë obligim ligjor .

Kërkoj nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që të na dërgojnë nga një fotografi për web faqen e Kuvendit

E hap Diskutimin për pikën të ndryshme.

z. Zef Komani: Unë dua që ta bëjë një vërejtje për kryesuesin sepse për anëtar të KPF-së e propozoj vetveten e ne si PSHDK edhe ashtu të kishim propozuar ty .

Kryesuesi: Ne kemi vepruar në bazë të ligjit sepse Kryesuesi i Kuvendit në mënyrë automatike është edhe kryesues i KPF-së .

z. Basri Komoni : Pak ditë na u dashen për të kuptuar mbylljen e komunës për publikun përmes vendimeve të Kryetarit Gjini që në dukje këto vendime janë tentim për të rikthyer pashallëkun e AAK-së në Institucionet lokale. Përmes këtyre vendimeve Kryetari Gjini tregoj se njerëzit e dhunës i dëshiron në Institucionet lokale ku kemi informata se është kthyer në punë në QKMF njeriu i cili e grushtoj drejtorin e QKMF-së ku Policia e ka hapur rastin dhe Prokuroria po i zhvillon hetimet dhe kjo ka ndodhur për arsye se ky është militant i AAK-së dhe ky është shembulli që Kryetari Gjini po i ofron qindra punëtorëve në Gjakovë apo është shembulli se muskujt duhet të triumfojnë mbi institucione. Konsiderojmë që qytetarët e meritojnë një shpjegim për kthimin në punë të militantit tuaj i cili e ka grushtuar drejtorin e institucionit, andaj kërkojmë nga ju që të na prezantoni vendimet dhe bazën ligjore të tyre .

Kryetari: Edhe paraardhësja ime edhe nënkryetari i Komunës që e ka ushtruar detyrën e ka pasur në tavolinën e tyre vendimi e Këshillit të pavarur mbikëqyrës që të kthehet në punë i njëjti person i cili vendim është obligativ që të kthehet në vend punës ky person . Në të njëjtën kohë unë kamë kërkuar me shkrim nga Prokuroria se a ka aktakuzë kundër Musë Gjergjaj dhe prokuroria ma ka kthyer me shkrim se nuk ka aktakuza dhe po u lexoj letrën e prokurorisë, pastaj e kamë dërguar edhe një shkresë dhe prapë më është kthyer se nuk ka aktakuzë kundër Musë Gjergjaj, dhe unë kamë vazhduar me procedurat e rregullta ligjore dhe krejt çka kamë vepruar është se e kamë respektuar ligjin. Nëse vjen ndonjë aktakuzë për cilindo zyrtar pavarësisht prej bindjes politike po ju them me përgjegjësi se as 20 minuta nuk do të më qëndroj në tavolinën time pa i marrë masat në përputhje me ligjin. Z. Musë Gjergjaj ka qenë punëtor i komunës para se unë me qenë kryetar i Komunës dhe letra nga Këshilli mbikëqyrës ka qenë në tavolinë para se unë me qenë kryetar i komunës andaj kur e bëni pyetjen duhet me i bërë edhe këto sqarime sepse është lehtë me bërë kësi pyetje

Znj. Mimoza Shala: Kemi një kërkesë nga një grup qytetarësh dhe OJQ që të ju bëjë thirrje dhe qytetarëve të Gjakovës që nesër me dt. 06 .01.2018 ti bashkëngjiti protestës që do të mbahet para kishës në Gjakovë

z. Shpend Komnova: Kërkoj që të kemi një raport mbi gjendjen e komunës nga drejtoritë përkatëse dhe raportet financiare që do të na mundësonte që të jemi më produktiv në punën tonë dhe njëkohësisht do të kishim një pasqyrë për situatën financiare projektet të cilat janë të nisura dhe projektet që do të nisën në vazhdimësi, andaj kërkoj nga Kryetari dhe drejtoritë përkatëse që në një të ardhme të afërt të na prezantojnë një raport të tillë .


Kryetari: Unë kamë kërkuar nga të gjithë drejtorët dhe nga administrata që të bëhet prerja financiare edhe për projektet edhe për gjendjen financiare dhe është duke u punuar edhe në drejtorin e financave dhe në Zyrën e prokurimit dhe së shpejti do të kemi këtë raporet , unë ju kamë premtuar se për borxhet në Komunë do të flas vetëm një dit dhe do të ju prezantoj pikë për pik të gjitha të gjeturat .

Kryesuesi: Unë e falënderoj Kryetarin për këto sqarime dhe e falënderoj këtë qeveri sepse nga punëtorët e administratës nuk është vërejtur ndryshimi i pushtetit e kjo tregon kulturën qeverisjes dhe mendoj se nuk ka arsye për këso reagime nga opozita .

Nëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u takofshin në takimin e radhës .


Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 10:45.

Procesmbajtës


Burim Bajrami



Kryesuesi i Kuvendit


Z. Anton Shala